



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-02/992/17
Data Datum Date	07-04-2017
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.04.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4702/16, për zyrtarin e lartë z. Ergin Sunguri, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4702/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ergin Sunguri, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Ergin Sunguri, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, figuron si person i autorizuar në dy biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z.Ergin Sunguri, ka ardhur në takim dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z.Sunguri, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se nuk ka pasur njohuri lidhur me çështjen konflikt të interesit, por ka theksuar se do ti marr të gjitha veprimet që të largohet nga personi i autorizuar në këto biznese dhe të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit edhe pse njeri nga këto biznese nuk zhvillon aktivitet.

Pas këtij takimi z.Sunguri, ka ndërmarr veprimet e nevojshme duke hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të funksionit si person i autorizuar në biznesin me emër "ERGIN SUNGURI B.I" me nr. biznesi 71286797, mirpo sa i përket biznesit tjetër ku është bashkëpronar me një person tjetër nuk ka mundur ti bëjë ndryshimet por është zotuar se në afatin sa më të shkurtër do ti kryej këto obligime.

Duke parë që procedura për ndryshimet në biznes po zvarritet nga z. Ergin Sunguri, Agjencia kundër Korrupsionit i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese ku e ka paralajmëruar që ti ndërmerr të gjitha veprimet për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar në të kundërtën Agjencia kundër Korrupsionit është e obliguar të veproj konform nenit 18.8 të Ligjit Nr.04/L- 051.

Me pastaj nga z.Ergin Sunguri, kemi pranuar dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se në biznesin me emër "N.T.P IPEKS me nr 70167011, z.Sunguri nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë, z.Ergin Sunguri, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Vushtrisë, janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

